



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor-Ministarstvo Sredine i Prostornog
Planiranja-Ministry of Environment and Spatial Planning

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm/Kancelarija Generalnog Sekretara/Office of Generaly Secretary

DATË/A:	16.03.2015
REFERENC-Ë:	ZSP-308/15
PËR/ZA/TO:	Komuna e Shtimes
CC:	
NGA/OD/FROM:	Arben Çitaku, Sekretar i Përgjithshëm i MMPH-së
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Shqyrtimi i kërkesës nga Komuna e Shtimes për Taksat për Leje të Ndërtimit për vitin 2015 me Nr.Protokolli 983/15 të datës 04.03.2015.

Të nderuar,

Bazuar në shkresën e datës 04.03.2015 me numër protokolli 983/15, lidhur me caktimin e taksës administrative për leje ndërtimore dhe tarifës për rritjen e densitetit të infrastrukturës nga Komuna e Shtimes (tutje si: Komuna) për vitin 2015, MMPH ka shqyrtuar dhe analizuar shkresën se bashku me dokumentacionin përcjellës dhe konstaton si në vijim:

Komuna ka propozuar Taksën Administrative të lejes ndërtimore në pajtim me Ligjin për Ndërtim Nr. 04/L-110 dhe Udhëzimin Administrativ Nr. 22/2012 për Lëshimin e Lejes së Ndërtimit dhe Tarifat për Rregullimin e Infrastrukturës.

Taksa Administrative për Lëshimin e Lejes së ndërtimit të llogaritur nga Komuna është **1.40 €/m²** (një euro e katër dhjetë cent për metër katror).

Tarifa për rritjen e densitetit të infrastrukturës është llogaritur konform Shtojcës 3 të UA Nr.22/2012, dhe kjo Tarifë duhet të llogaritet vetëm për njësit të reja të banimit, konform formulës së përcaktuar në nenin 10, paragrafi 1 i UA nr.22/2012.

Komuna duhet të procedojë për aprovim taksat për lëshimin e lejes së ndërtimit për vitin 2015 në pajtim me procedurat e parapara me Ligjin për Ndërtim Nr. 04/L-110.

Me respekt.

Faqe 1 nga 1